

RRUGËTIMI I PARASË

LIGJI "PËR BANKËN E SHQIPËRISË"

Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive dhe është emetuesja e vetme e kartëmonedhës dhe monedhës kombëtare që ka kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë përcakton format, masat, peshat, modelin dhe karakteristikat e tjera të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare që kanë kurs ligjor.

Kartëmonedhat dhe monedhat e pavlefshme tërhiqen, asgjësohen dhe zëvendësohen me kartëmonedha dhe monedha metalike nga Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë sekuestron dhe konfiskon kartëmonedhat dhe monedhat metalike false.

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkonti në adresën:

Banka e Shqipërisë
Sheshi "Avni Rustemi", Nr. 24, Tiranë,
Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4
2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 8000 kopje
Shtypur në shtypshkronjën AdelPRINT

Banka e Shqipërisë, në përmbushje të funksioneve të saj si banka qendrore e Republikës së Shqipërisë, emeton dhe hedh në qarkullim të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat metalike që kanë kurs ligjor brenda territorit të Shqipërisë.

Pas prodhimit të monedhave dhe të kartëmonedhave në një nga kompanitë e specializuara për këtë jashtë vendit, Banka e Shqipërisë furnizon me kartëmonedhë dhe monedhë metalike degët e saj, në pesë qytete kryesore të vendit dhe përmbush nevojat për para të të gjitha bankave tregtare.




Individët dhe bizneset tërheqin paratë që i nevojiten

për të shlyer pagesat dhe për të kryer blerje nga sportelet dhe ATM-të e bankave tregtare.

Pas printimit të kartëmonedhave dhe prodhimit të monedhave metalike ato transportohen në Bankën e Shqipërisë.

QARKULLIMI I MONEDHËS



Më pas, bankat tregtare furnizohen me para. Bankat tregtare plotësojnë nevojat për para të individëve dhe bizneseve.

Dyqanet dhe bizneset, i depozitojnë paratë që kanë përfituar nga konsumatorët në bankat tregtare, e kështu i gjithë procesi nis nga fillimi.

Bankat tregtare depozitojnë në bankën qendrore cash-in që përftojnë nga publiku dhe përmes procesit të rikthimit të kartëmonedhave në bankën qendrore bëhet i mundur sortimi i parasë në qarkullim.

PËRPUNIMI I MONEDHËS



Banka qendrore kujdeset që paraja në qarkullim të jetë në gjendje sa më të mirë. Për këtë arsye, me të mbërritur në Bankën e Shqipërisë, kartëmonedhat lekë i nënshtrohen një procesi të gjatë rinumërimi, analizimi, seleksionimi dhe klasifikimi për t'u rikthyer edhe një herë në qarkullim ose nëse kartëmonedha rezulton e dëmtuar, për t'u shkatërruar. I gjithë ky proces kryhet falë makinerive të posaçme që veçojnë dhe shkatërrojnë kartëmonedhat e dëmtuara, të cilat më pas zëvendësohen me të reja.

Përveç gjendjes fizike të kartëmonedhës, banka qendrore ruan edhe vlerën e saj përmes eliminimit të kartëmonedhave false.